



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, me \_\_\_\_ . 04. 2023

**LËN DA:** Për masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2023<sup>1</sup>.

**PROKURORIVE TË RRETHIT GJYQËSOR**

**PROKURORISË TË APELIT**

**TIRANË**

**DREJTORIVE DHE SEKTORËVE**

**KË T U**

Në kuadrin e kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore në prokurori<sup>2</sup> dhe mbikëqyrjes<sup>3</sup> të zbatimit të masave administrative dhe procedurale në periudhën para dhe pas zgjedhore të normuara në udhëzimin e përgjithshëm nr.3/2019<sup>4</sup>, i ndryshuar, ju sjellë në vëmendje, drejtuesve të prokurorive dhe prokurorëve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, të vlerësojnë marrjen e masave efçente administrative për organizimin dhe funksionimin e gatishmërisë në prokurori për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore datë 14 maj 2023 në zbatim të kushtetutës, ligjit dhe akteve normative të detyrueshme në prokurori, si dhe të vlerësojnë në dinamikë gjendjen, ecurinë dhe nevojat e marrjes së masave efektive procedurale, për rritjen e intensitetit të hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj veprave penale që prekin zgjedhjet e lira në njësitë administrative që mbulon rrethi gjyqësor i asaj prokurorie, forcimin e bashkërendimit dhe

<sup>1</sup> Shih, dekretin nr.13864, datë 24 tetor 2022 , ku është dekretur caktimi i datës 14 maj 2023 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

<sup>2</sup> Shih, nenin 38 pika 2 shkronja “f” e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

<sup>3</sup> Shih, po aty neni 38 pika 2 shkronja “b”;

<sup>4</sup> Shih, udhëzimin e përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore” i ndryshuar/plotësuar me udhëzimin e përgjithshëm i PP nr.2/2021, datë 31.03.2021.

koordinimit me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Posaçme dhe/ose agjensi të tjera ligjzbatuese, si dhe zbatimin nga drejtuesi i prokurorisë të kompetencave ligjore<sup>5</sup>, sipas fazave të procedimit penal, me synim si parandalimin e posaçëm nëpërmjet hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale efektive ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të veprave penale të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, ashtu dhe parandalimin e përgjithshëm të këtyre veprave në periudhën para, gjatë dhe pas zgjedhore, veçanërisht në drejtimet:

1. Drejtuesit e prokurorive të rretheve gjyqësore sipas kompetencës tokësore marrin masa për organizimin dhe funksionimin e gatishmërisë së përforcuar në prokuroritë që drejtojnë, sipas udhëzimit përgjithshëm nr.3/2019 (i ndryshuar), duke filluar me datë 14 prill 2023 që sipas ligjit<sup>6</sup> fillon fushata zgjedhore deri me shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve<sup>7</sup> nga KQZ-ja të organeve të qeverisjes vendore në njësitë administrative që mbulon rrethi gjyqësor i asaj prokurorie.

2. Struktura përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme e ngritur me urdhrin nr.47, datë 03.04.2023 është pika e kontaktit që bashkërendon, koordinon dhe shkëmben informacion me KQZ-në, agjensite ligjzbatuese, përfaqësues të insitucioneve ndërkombëtare në vendin tonë dhe me drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimor, ndalimin e publikimit të akteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas përcaktimeve në ligj<sup>8</sup>.

2.1 Në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të krijohet rubrika për të ftuar qytetarët të kallëzojnë shkeljet e ligjit që kanë dijeni ose që kanë cënuar interesat e tyre si zgjedhës ose të konstatuara prej tyre, në periudhën para zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve;

2.2 Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme trajton me prioritet kërkesat e KQZ-së, dhe jo vetëm, për verifikimin e integritetit të personave kandidat për tu zgjedhur, në zbatim të ligjit nr.138/2015 dhe udhëzimeve të përgjithshme nr.18/2020 e nr.3/2019 i ndryshuar.

3. Drejtuesit e prokurorive dhe prokurorët sipas kompetencës lëndore e tokësore në fazën e hetimeve paraprake, vlerësojnë dhe trajtojnë me prioritet dhe në afate optimale, çdo referim dhe/ose kallëzim për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të çdo vepre tjetër penale që dëmton procesin zgjedhor, lidhur me ekzistencën e kushteve/kritereve ligjorë për regjistrimin e procedimit penal dhe në bashkërendim me KQZ-në për kallëzimet e paraqitura prej saj, dhe/ose me agjensitë ligjzbatuese të specializuara, për kryerjen e hetimeve proaktive, dhe/ose përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit sipas ligjit, si dhe rritjen e intensitetit të hetimeve për këto grupvepra penale.

---

<sup>5</sup> Shih, nenin 42, 43, 45, 46, 48 e vijues të ligjit nr.97/2016 .

<sup>6</sup> Shih, nenin 77 të Kodit Zgjedhor, që në pikën 1 parashikon: “1. Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve...”.

<sup>7</sup> Shih, po aty pikën 18 të nenin 2 ”“Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor”

<sup>8</sup> Shih, nenet 103, 279 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 5, 18 e vijues të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

3.1 Prokurorët i delegojnë veprimet hetimore oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokurori dhe/ose të shërbimeve policore në strukturat hetimore përkatëse, duke urdhëruar, si kryerjen e veprimeve intensive hetimore të nevojshme, ashtu dhe përcaktojnë afate kohore të përshpejtuara për kryerjen e tyre dhe mbikëqyrin periodikisht zbatimin e urdhërimeve të tyre, deri në përfundim të hetimeve paraprake për secilin procedim për grupveprat penale në këtë fushë.

4. Prokurorët bëjnë kujdes në prioritizimin dhe rritjen e intensitetit të veprimeve procedurale penale, për të siguruar: -hetime të plota, gjithëpërfshirëse dhe afate optimale të hetimeve; -vlerësimin e zgjidhjes ligjore përfundimtare të hetimeve paraprake; -ngritjen e akuzës në gjykatë bazuar në rrethana fakti të provuara dhe në ligjin material penal e procedural penal të zbatueshëm; -përfaqësimin e akuzës/çështjes në gjykatë me pavarësi, profesionalizëm dhe integritet, duke siguruar mbrojtjen e zgjedhjeve të lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, ashtu dhe garantuar liritë personale dhe interesat e ligjshme të shtetasve, si dhe procesin e rregullt ligjor.

5. Prokurorët në kërkesat për caktimin e masave të sigurimit personal dhe për caktimin e masave të dënimit për këto grupvepra penale, të bëjnë kujdes dhe vlerësojnë ashpërsimin e kërkimëve, si për llojin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe për llojin dhe masat e dënimit për veprat penale në fushën e zgjedhjeve që janë më të përhapura dhe me tendencë në rritje në shkallë vendi, apo në njësitë administrative në kompetencë tokësore të rrethit gjyqësor të gjykatës pranë të cilës ushtron funksionet ajo prokurori.

6. Drejtuesi i prokurorisë<sup>9</sup>, i cili përgjigjet sipas ligjit<sup>10</sup> për mbarëvajtjen e hetimeve të këtyre veprave penale, kur e vlerëson të nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit/çështjes konkrete, nxjerr udhëzim jo të detyrueshme me shkrim<sup>11</sup> për prokurorin përkatës, për kryerjen e detyrave specifike për të garantuar një hetim të plotë e të gjithanshëm dhe në afate optimale, në kuadrin e një procedimi të drejtë dhe të rregullt ligjor, si dhe ndjek në dinamikë veprimtarinë e procedimeve, duke kërkuar informacion nga prokurorët për ecurinë e procedimeve dhe verifikuar përfundimin e secilës çështje, dhe/ose duke nxjerrë udhëzime me shkrim sipas ligjit në rastet kur vlerësohet e nevojshme kryerja e veprimeve të mëtejshme procedural, përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake nga prokurori<sup>12</sup>.

7. Struktura përkatëse dhe/ose prokurori i caktuar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe drejtuesit e prokurorive e prokurori për marrëdhëniet me publikun në secilën prokurori, marrin të gjitha masat administrative të nevojshme për bashkërendimin dhe koordinimin institucional dhe ndër-institucional, për të siguruar dhe shkëmbyer informacione dhe dërgimin Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, sipas ligjit dhe udhëzimit të përgjithshëm nr.3/2019 i ndryshuar dhe udhëzimit të përgjithshëm nr.5/2019 “Për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

<sup>9</sup> Shih, shkronja “c”, pika 1 e nenin 48 “Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete” të ligjit nr.97/2016.

<sup>10</sup> Shih, nenin 43 të ligjit nr.97/2016, i ndryshuar me nenin 1 të ligjit nr.148/2020, hyrë në fuqi me date 28.01.2021 (FZ-Nr.5/2020), i cili ka shtuar shkronjën “e” me këtë përmbajtje: “e) përgjigjet për hetimin e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të cilat janë kompetencë e prokurorisë që drejton”

<sup>11</sup> Shih, shkronjat “b”, “c”, “ç” e vijues nenin 43 në lidhje me nenin 48 të ligjit nr.97/2016.

<sup>12</sup> Shih, pikat 3, 4 e vijues të nenin 48 të ligjit nr.97/2016.

Me këtë qarkore të njihen gjithë prokurorët, drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe të shërbimeve të policisë gjyqësore që ushtrojnë funksionet pranë strukturave hetimore përkatëse. Drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe struktura përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme të marrin masat e duhura organizative dhe ligjore, për zbatimin, mbikëqyrjen dhe informimin për zbatimin e kësaj qarkore në lidhje me udhëzimet e përgjithshme nr.3/2019 i ndryshuar, nr.18/2020 dhe nr.5/2019.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**